



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/33

Datë: 28.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/33

Datë: 28.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, bazuar në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2020-2023 i aprovuar me Vendimin e Qeverisë nr. 01/02 datë 05.06.2020, Vendimin e Qeverisë nr. 01/23 datë 13.08.2020 në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Planifikimi dhe Zbatimi i Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike Masa 10-Mbështetje Financiare për Projektet dhe iniciativat që synojnë përmasimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi.
2. Obligohet Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të zbatoj dhe monitoroj Planin sipas pikës 1. të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/33

Datë: 28.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Me qëllim të zbatimit të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE) në sektorin e bujqësisë, konkretisht Masës 4A - dyfishimi i buxhetit për Programin për Pagesa Direkte vetëm për vitin 2020, të paraparë në paragrafin 1.4, nën-paragrafin 1.4.1, dyfishohen vlerat e pagesave direkte (subvencioneve) për secilën kulturë/masë të paraparë në Programin e Pagesave Direkte për vitin 2020, krahasuar me vlerat e vitit 2019.
2. Kriteret për ndarjen e subvencioneve sipas pikës 1. të këtij vendimi janë të përcaktuara në Programin e Pagesave Direkte për vitin 2020 dhe në Udhëzimin Administrativ (MBPZhR) Nr. 03/2020 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2020.
3. Obligohen Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Më datë 13 gusht 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr vendimin nr. 01/23, me të cilin ka aprovuar Planin për zbatimin e Programit për Rimëkëmbje Ekonomike dhe ka përgatitur shtojcën (*më tutje Shtojca*) "Plani operacional për zbatimin e Programit për Rimëkëmbje Ekonomike".

Paragrafi 1.4, i vendimit nr. 01/23, Masa 4 shprehimisht thotë se Programi për Rimëkëmbje Ekonomik parasheh "Rritjen e prodhimit bujqësor vendor, rritjen e punësimit në zonat rurale, zvogëlimin e importit të produkteve bujqësore, tejkalimin e sfidave nga mungesa e shitjeve nga COVID-19 dhe rritjen e sigurisë së ushqimit", teksa Masa 4A parasheh "Dyfishimin e buxhetit për Programin për Pagesat Direkte vetëm për vitin 2020".


Mbi bazën e këtyre masave është përgatitur Shtojca shpjeguese dhe tabelare, e cila në tabelën nr. 4 [Bujqësi] pika (a) - Dyfishimi i buxhetit për Programin për Pagesat Direkte për vitin 2020 obligon Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (*më tutje MBPZHR*) që të përshtat kriteret për zbatim në përputhje me PRE.

Fillimisht, natyra dhe specifika e Programit për Pagesa Direkte në esencë është e tillë që përcakton plane, parasheh nxjerrje të udhëzimit dhe bën ndarjen e kriterëve sektoriale, dhe në këtë aspekt MBPZHR ka përgatitur Programin për Pagesa Direkte (PPD) për vitin 2020, ku specifikisht definon se cilat kultura bujqësore mbështeten. Ky Program ka kaluar të gjitha procedurat e parapara ligjore të përcaktuara në Rregulloren Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar.

Tutje, si dokument pasardhës i PPD 2020 është përpiluar Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2020 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2020, i cili përbën bazën ligjore, profesionale dhe thelbësore në ndarjen, mënyrën e ndarjes, kushtet dhe kriteret sektoriale e përcaktuese të pagesave direkte (subvencioneve). Ky udhëzim administrativ ka kaluar të gjitha procedurat e parapara ligjore siç janë të përcaktuara në Rregulloren Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/33

Datë: 28.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për anashkalimin e procedurave të përcaktuara me Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe përfshirjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Programin Legjislativ të vitit 2020 pa kaluar paraprakisht procedurën e aprovimit të Koncept Dokumentit.
2. Hiqet nga Plani i Punës së Qeverisë 2020-2022 dhe nga lista e Koncept Dokumenteve 2020, Koncept Dokumenti për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
3. Obligohet Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit që ta përfshijë në Programin Legjislativ 2020, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/33

Datë: 28.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit i Ministrisë së Financave – Thesari i Kosovës për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2019.
2. Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të zbatojnë Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas pikës 1. të këtij vendimi.
3. Obligohen të gjitha organizatat buxhetore që në baza të rregullta (gjashtëmujore) të raportojnë te Ministria e Financave – Thesari i Kosovës, sipas formatit dhe afateve të përcaktuara për progresin dhe nivelin e zbatimit të këtyre rekomandimeve.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit që planin e zbatimit të rekomandimeve nga pika 1. e vendimit t'ia dërgojë Komisionit për Buxhet dhe Transfere në Kuvendin e Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Thesarit të Kosovës dhe të gjitha Organizatave Buxhetore
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/33

Datë: 28.09.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të objekteve të vjetëruara të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) e të cilat gjenden në parcelat nr. 1791-2 dhe nr. 1792-0 pronë e Komunës së Istogut, të cilat preken nga realizimi i projektit "Rregullimi i Qendrës së Qytetit në Istog", konform Planit Zhvillimor Komunal 2018-2026, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Kompensimi i vlerës së pronës, shpenzimet e procedurës së shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhen nga Komuna e Istogut në kordinim me Ministrinë e Financave dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), konform legjislacionit në fuqi.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit, Ministria e Financave dhe Komuna e Istogut.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/33

Datë: 28.09.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19, 50 (4), (5) dhe 52 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi shtesë për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Rrugës Nacionale N2 Prishtinë-Mitrovicë, Segmenti Gojbulë - Smrekovnicë Loti I, zonat kadastrale: Smrekovnicë, Dobërllukë, Bajskë, Sllatinë (Gjelbrishtë), Vushtri dhe Gojbulë të Komunës së Vushtrisë, sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave të bashkëngjitur këtij vendimi në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit i dërgonë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit dhe aplikimit të pronarëve për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/33

Datë: 28.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 25 të Ligjit Nr .03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë për vitin 2018-2019.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoi Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/33

Datë: 28.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e "Zyrës për ofrimin e asistencës për qytetarët e Luginës së Preshevës" në kuadër të ZKM-së

1. Themelohet "Zyra për ofrimin e asistencës për qytetarët e Luginës së Preshevës" në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
2. Zyra themelohet me qëllim që të ofrojë mbështetje për qytetarët që jetojnë në rajonin e Luginës së Preshevës.
3. Kryeministri emëron Drejtorin e "Zyrës për ofrimin e asistencës për qytetarët e Luginës së Preshevës", që është njëkohësisht edhe këshilltarë i Kryeministrit dhe i përgjigjet drejtpërdrejtë atij.
4. Zyra do të punësojë dy (2) asistentë profesional që do kryejnë punë administrative të zyrës.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes kësaj zyreje, bazuar në legjislacionin në fuqi, angazhohet të ndërmarrë masat e nevojshme që të lehtësojë dhe përmirësojë jetën e qytetarëve që jetojnë në Luginën e Preshevës në fushat si në vijim, por duke mos u kufizuar vetëm në to:

4.1. Në fushën e arsimit dhe kulturës:

- 4.1.1. Do të mbështeten iniciativat e nisura më parë (siç është Memorandumi për Bashkëpunim në mes të Këshillit Kombëtar Shqiptar dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe memorandume të tjera, financimi i ndërtimit të shkollës së muzikës etj.);
- 4.1.2. Furnizimi i rregullt me tekste të domosdoshme shkollore;
- 4.1.3. Furnizimi i bibliotekave me libra të nevojshëm;
- 4.1.4. Pranimi i studentëve nga Lugina e Preshevës në Universitetet Publike bazuar në kuotat e përcaktuara që marrin parasysh nevojat e institucioneve arsimore dhe institucioneve të tjera në Luginë si dhe mbështetja e tyre gjatë studimeve;
- 4.1.5. Mbështetja e aktiviteteve kulturore dhe aktiviteteve sportive;

- 4.1.6. Mbështetja e mediave lokale dhe OJQ-ve të cilat në objektivat e tyre kanë aktivitetet arsimore, kulturore dhe rinore;
- 4.1.7. Mbështetje tjetër sipas nevojës dhe legjislacionit në fuqi.

4.2. Në fushën e ekonomisë:

- 4.2.1. Mbështetje e bashkëpunimit të shoqatave të bizneseve nga Kosova me bizneset dhe shoqatat nga Lugina e Preshevës;
 - 4.2.2. Mbështetje e bizneseve nga Lugina për të marrë pjesë në panairë dhe organizime të tjera biznesore në Kosovë;
 - 4.2.3. Inicimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkufitar të komunave në Kosovë dhe ato në Luginë;
 - 4.2.4. Përcaktimin e një kuote për qytetarët e Luginës në Programin e trajnimit për zanate të ndryshme;
 - 4.2.5. Mbështetje tjetër sipas nevojës dhe legjislacionit në fuqi.
6. Zyra do trajtojë edhe çështjet të tjera që nuk janë listuar në këtë vendim por që dalin si kërkesa dhe nevoja eventuale nga qytetarët që jetojnë në Luginën e Preshevës.
 7. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që të mbikëqyrë funksionimin administrativ të kësaj zyreje në realizimin e detyrave, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
 8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Qytetarët që jetojnë në Luginën e Preshevës po përballen me probleme dhe vështirësi të ndryshme në aspektin social, arsimor, kulturor dhe ekonomik, siç janë tekstet shkollore, diploma, kuadri i kualifikuar arsimor etj. Duke marrë parasysh problemet me të ballafaqohen qytetarët e Luginës së Preshevës, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ofrojë asistencën e saj që të lehtësojë jetën e tyre, duke u kujdesur për ta përmes Zyrës së veçantë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/33

Datë: 28.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 04/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, bazuar në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023 i aprovuar me vendimin e Qeverisë nr. 01/02 datë 05.06.2020, në zbatim të vendimit nr. 01/23 të datës 13.08.2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:


V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike në vlerë prej tetëdhjetë e shtatë milionë euro (87,000,000 €), nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për organizatat buxhetore dhe masat e programit si në vijim:
 - 1.1. Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit me kod 213, në nën-programin Ndërmarrësia me kod 49400, ndahen gjashtëdhjetë milionë euro (60,000,000 €). Ndarja e mjeteve bëhet për subvencionimin e linjës së pagave për bizneset aktive, bazuar në numrin e të punësuarve të deklaruar në deklaratën e tatimit në pagë të muajit dhjetor 2019, që plotësojnë kushtet si në vijim:
 - Të kenë statusin e tatimpaguesit aktiv në muajin korrik 2020 në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës, si dhe
 - Të kenë të dorëzuar deklaratën vjetore, tremujore dhe deklaratën për tatimin e mbajtur në burim në paga, sipas legjislacionit në fuqi.
 - 1.1.1. Subvencionimi nga pika 1.1 e këtij vendimi përfshin edhe bizneset e regjistruara gjatë periudhës janar - gusht 2020. Në këtë rast, subvencionimi bazohet në numrin e të punësuarve të deklaruar për muajin korrik 2020.
 - 1.1.2. Përrjashtimisht nga pika 1.1 dhe 1.1.1, nga ky subvencionim sipas këtij vendimi nuk përfitojnë Ndërmarrjet Publike dhe bizneset/ndërmarrjet që operojnë në sektorët që kanë tregun e rregulluar nga Rregullatorët.
- 1.2. Në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale me kod 209, në nën-programin Ndihamat Sociale me kod 00500, kategorinë e shpenzimeve "Subvencionet dhe Transferet", ndahen shtatë milionë e pesëqind mijë euro (7,500,000 €), për dyfishimin e pagesës së skemës së asistencës sociale për periudhën tetor-dhjetor 2020. Kjo pagesë realizohet në baza mujore së bashku me pagesën e rregullt të kësaj skeme sociale.

- 1.3. Në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kod 203, nën-programin Departamenti i Politikave Bujqësore, me kod 40100, kategorinë e shpenzimeve "Subvencionet dhe Transferet", ndahen dymbëdhjetë milionë euro (12,000,000 €) për dyfishimin e shumës së subvencioneve, krahasuar me 2019, për secilën kulturë/masë, sipas kritereve dhe procedurave të Programit për Pagesat Direkte për vitin 2020 dhe udhëzimit administrativ (MBPZHR) Nr. 03/2020 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2020.
 - 1.4. Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit me kod 213, nën-programin Ndërmarrësia me kod 49400, ndahen një milion euro (1,000,000 €), për mbështetjen e sektorit privat në fusha specifike.
 - 1.5. Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit me kod 213, nën-programin Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike me kod 23300, kategoria e shpenzimeve "Subvencionet dhe Transferet", ndahen një milion euro (1,000,000 €), për mbështetjen e ndërmarrjeve publike.
 - 1.6. Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me kod 207, ndahen dy milionë e pesëqind mijë euro (2,500,000 €) në këto nën-programe dhe shuma: në nën-programin Sportet e Gjera me kod 80100 në shumë prej një milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë euro (1,539,000 €), në nën-programin Zhvillimi dhe Përkrahja e Rinisë me kod 80700 në shumë prej pesëqind mijë euro (500,000 €) dhe në nën-programin Përkrahja e Kulturës me kod 80500, në shumë prej katërqind e gjashtëdhjetë e njëmijë euro (461,000 €), kategoria e shpenzimeve "Subvencionet dhe Transferet".
 - 1.7. Në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal me kod 221, nën-programin Administrata Qendrore - MZHR me kod 11321, kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", ndahen një milion euro (1,000,000 €).
 - 1.8. Në Zyrën e Kryeministrit me kod 104, nën-programin Zyra për Komunitete me kod 15600, kategorinë e shpenzimeve "Subvencionet dhe Transferet", ndahen një milion euro (1,000,000 €).
 - 1.9. Në Zyrën e Kryeministrit me kod 104, nën-programin Agjencioni për Barazi Gjinore me kod 15300, kategorinë e shpenzimeve "Subvencionet dhe Transferet", ndahen një milion euro (1,000,000 €).
2. Për pikat me numër rendor nga 1.4-1.9 të këtij vendimi, alokimi i mjeteve nga Thesari për shpenzim nga organizatat buxhetore të lartpërmendura bëhet vetëm pas miratimit të kritereve përkatëse për zbatim të masave nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike. Mjetet alokohen në kodin e dedikuar (00098) për ekzekutim të mjeteve nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike.
 3. Masat me numër rendor nga 1.1-1.3 fillojnë zbatimin menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa Ministrinë/organizatat buxhetore përgjegjëse për zbatim të masave sipas pikave 1.4-1.9 të këtij vendimi duhet të sjellin propozimet me kritere për miratim nga Qeveria në afatin sa më të shkurtër.
 4. Obligohet Ministria e Financave dhe të gjitha ministrinë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/33

Datë: 28.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi Nr. 05/18 i datës 29.07.2020, në pikën 1.5 si në vijim:

1.5. Organizatat buxhetore janë përgjegjëse të përgatisin dhe të aprovojnë me shkresë përmes ZKA dhe ZKF të organizatës listat e personelit të tyre shëndetësor në përputhje me pikën 1.1 dhe 1.2 dhe të njëjtat përcillen në Ministrinë e Shëndetësisë, e cila pasi konstaton përputhshmërinë me kriteret e këtij vendimi dhe udhëzimet e saj, përmes Ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm me shkresë të veçantë i dërgon në Thesarin e Kosovës (MF) për procesim përmes Sistemit të Pagave, përkatësisht pagesë retroaktive për dy muaj, së bashku me pagesën e pagesë mujore të muajit vijues gjatë vitit 2020.

2. Ky ndryshim është i vlefshëm vetëm për pjesën e pazbatuar të vendimit, përkatësisht për institucionet (organizatat buxhetore) të pikës 1.3.2 dhe kriterëve të pikës 1.2. të këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/33

Datë: 28.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 52 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Fatos Qerimi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, transferohet në pozitën, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.
2. Transferimi i z. Qerimi bëhet për kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësi në bazë të legjislacionit në fuqi brenda mandatit të përcaktuar me Vendimin e Qeverisë nr. 16/35 të datës 09.03.2018.
3. Obligohet Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/33

Datë: 28.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 04/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, bazuar në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023 i aprovuar me vendimin e Qeverisë nr. 01/02 datë 05.06.2020, në zbatim të vendimit nr. 01/23 të datës 13.08.2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani për implementimin e Programit për Rimëkëmbje Ekonomike Masa 8 "Mbështetje për programet ekzistuese dhe të reja që lidhen me zhvillimin rajonal të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, që ndikojnë në zhvillimin rajonal të balancuar".
2. Ndahen mjetet për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, sipas masës 8 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/23 të datës 13.08.2020 për aprovimin e Planit për zbatimin e Programit të Rimëkëmbje Ekonomike në vlerë prej një milion euro (1,000.000.00 €) për mbështetje për programet ekzistuese dhe të reja që lidhen me zhvillimin rajonal dhe që ndikojnë në zhvillimin rajonal të balancuar.
3. Obligohet Ministria e Financave për alokimin e mjeteve të Ministria e Zhvillimit Rajonal sipas pikës 2. të këtij vendimi.
4. Obligohet Ministria e Zhvillimit Rajonal që konform Planit, udhëzimit dhe kriteret sektoriale, të zhvilloj procedurat e mëtejme për implementimin dhe zbatimin e masave të përcaktuara në Programin për Rimëkëmbje Ekonomike.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/33

Datë: 28.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Draftet e marrëveshjeve që do të nënshkruhen në mbledhjen e përbashkët të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë si në vijim:
 - 1.1. Deklaratë e Përbashkët ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për t'i Rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Mbikëqyrjen e Zbatimit të Marrëveshjeve të nënshkuara në mes të dy Qeverive;
 - 1.2. Protokoll i Shtesë i Marrëveshjes së Bashkëpunimit në Fushën e Shëndetësisë ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë, në përballje me COVID 19;
 - 1.3. Kalendari i Përbashkët Kulturor Vjetor mes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës, të Republikës së Shqipërisë;
 - 1.4. Marrëveshje për Bashkëpunim të Filmit ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë;
 - 1.5. Memorandumi i Bashkëpunimit në fushën e librit dhe veprimtarisë botuese, ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë;
 - 1.6. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim dhe Ndihmë të Ndërsjellë në Raste të Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive tjera;
 - 1.7. Marrëveshje e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë për Mobilitetin në Punë;
 - 1.8. Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë për Platformën e Përbashkët Digjitale të Arsimit Parauniversitar;
 - 1.9. Protokoll për Ndryshim dhe Shtesë në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim të Ndërsjellë në Fushën e Sigurisë;

- 1.10. Memorandumi i Bashkëpunimit për Krijimin e Korridorit Digjital 5G, dhe Lehtësimin e Lëvizjes në të Ardhmen ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë;
- 1.11. Protokolle Ndryshues i Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë Lidhur me Tatimet Mbi të Ardhurat dhe Mbi Kapitalin dhe për Parandalimin e Evazionit Fiskal;
- 1.12. Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë për ngritjen e Grupit Punues për Krijimin e Fondit të Përbashkët në Mbështetje të Luginës së Preshevës;
- 1.13. Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin në Fushën e Transportit Hekurudhor;
- 1.14. Memorandumi i Bashkëpunimit për themelimin e Ligës së Përbashkët të Basketbollit ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë;
- 1.15. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Zbatimin e Lehtësirave të Ndërsjella në Procedurat Doganore dhe /ose të Kontrollit të Hyrje/Daljes së Mallrave.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë